



Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Ljubllanës) Kati V-te, Prishtinë, Kosovë
Tel:+ 383 38 212 309 e-mail oshp@rks-gov.net

PSh. Nr. 3050/23

Paneli Shqyrtues i Prokurimit, i emëruar nga Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) në bazë të nenit 105 dhe 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës Nr. 04/L-042 (i amendamentuar), në përbërje nga Vedat Poterqoi- Kryetar, Vjosa Mexhuni Gradinaj-Anëtare dhe Isa Hasani- Anëtar, pas shqyrtimit të kërkesës për diskualifikim të ushtruar nga Policia e Kosovës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) (Nr. Protokolli 3050/23), ushtruar ndaj Operatorit Ekonomik (OE) "Creative Design", lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me spaleta- ritender", me numër të prok: 214-23-12509-1-2-1, duke u bazuar në nenin 99 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës dhe nenit 32 të Rregullores së Punës së OSHP, me 28.02.2024, mori:

V E N D I M

I. Aprovohet, si e bazuar kërkesa e Policisë së Kosovës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, e datës 27.12.2023, kurse OE "Creative Design" diskualifikohet nga pjesëmarrja në aktivitetet e prokurimit për periudhën kohore në kohëzgjatje 1/një viti, duke filluar nga data 28.02.2024 deri me datën 27.08.2024, për shkak të prezantimit të dokumenteve të falsifikuara, vepër kjo e parashikuar me nenin 99, paragrafi 2 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

II. Urdhërohet AK (me shënime si më sipër) që ta konfiskoj shumën e mjeteve të deponuara nga OE "Creative Design" në emër të sigurimit të ofertës, siç parashihet me nenin 57, paragrafi 1.1, të LPP.

III. Revokohet masa e shqiptuar si në paragrafin 1, të dispozitivit të këtij Vendimi, nga dita kur dhe nëse OSHP njoftohet me aktin e organeve kompetente, sipas të cilit është vendosur ndryshe në raport me Vendimin e marrë në këtë rast.

A r s y e t i m

Me 27. 12. 2023, nga Policia e Kosovës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka dorëzuar në OSHP, kërkesë për aplikim të masave sipas nenit 99 të LPP, ndaj OE "Creative Design" me arsyetimin se i njëjti ka ofruar dëshmi të falsifikuara në këtë aktivitet të prokurimit, precizuar si në hyrje të këtij vendimi.

Nga shkresat e kësaj lënde kuptohet se OE "Creative Design" ka aplikuar në aktivitetin e prokurimit "Furnizim me spaleta- ritender", me numër të prok: 214-23-12509-1-2-1.

AK-Policia e Kosovës me datën 26/11/2021 ka bërë publikimin e njoftimit për kontratë përmes platformës së Prokurimit Publik (e-prokurimit), duke përdorur procedurën e hapur me afate të rregullta kohore. Data e dorëzimit të ofertave ka qenë 01/12/2023 dhe kanë pranuar gjithsej tri (3) oferta përmes prokurimit elektronik për këtë aktivitet të prokurimit. Aktiviteti i prokurimit në fjalë është publikuar tri here radhazi gjatë vitit, herën e parë aktiviteti i prokurimit "Furnizim me Spaleta" 214-23-5853-1-2-1 në fjalë është publikuar me date 12.06.2023 ndërsa hapja e ofertave është bërë me datë 12.07.2023 ku OE N.T.SH. "Creative Design" ka qenë ofertues dhe ka dorëzuar Atestet nga Laboratori "Euromak Kontrol" me numër të testimit 25/23/te datës 10.07.2023.

Herën e dytë aktiviteti i prokurimit në fjalë është ri-tenderuar me date 25/07/2023 është bërë publikimi i njoftimit për kontratë ndërsa me hapja e ofertave është bërë me datë 04.09.2023 ku OE N.T.SH. "Creative Design" ka qenë ofertues dhe ka dorëzuar Atestet nga Laboratori "Euromak Kontrol", me numër të testimit 25/23/ te datës 10.08.2023.

Aktiviteti i prokurimit është ri-tenderuar për herën e tretë pasi dy herët e para është anuluar në mungesë të ofertave të papërgjegjshme ku publikimi i njoftimit për kontratë "Furnizim me Spaleta" 214-23-125094-2-1 është bërë me date 09.11.2023 ndërsa hapja e oferta është bërë me datë 01.12.2023 ku OE N.T.SH. "Creative Design" ka qenë ofertues dhe ka dorëzuar Atestin nga Laboratori "Euromak Kontrol" me numër të testimit 25/23/ te datës 10.07.2023. Komisioni i vlerësimit gjatë vlerësimit krahasimit ekzaminimit të ofertës ka hasur që ky Atest është me numër të njëjtë si të Atestet paraprake e që përmban të dhëna të ndryshme. Komisioni ka pasur dyshim në lidhje me datën e tyre dhe numrin e njëjtë të tri atesteve ndërsa numri i atestit i njëjtë. AK me datën 15.12.2023 dërgon e-mail tek laboratori Euromak Kontrol, Skopje, Macedoni duke ja bashkangjitur tri atestet dhe kërkon të vërtetohet se a janë lëshuar nga ky laborator.

Me datën 19.12.2023 AK- Policia e Kosovës kërkon sqarime nga OE "Creative Design" për tri atestet e dorëzuara në tri aktivitetet e prokurimit "Furnizim me Spaleta" të publikuar tri herë dhe OE në fjalë me datë 21.12.2023 kthen përgjigjeje tek Autoriteti Kontraktues (të bashkangjitura dhe të verifikuara si prova nga ekspertit shqyrtues dhe paneli shqyrtues i OSHP-së).

Pas pranimit të kërkesës së autoritetit kontraktues OSHP ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të shqyrtuar kërkesën e dorëzuar të AK-së dhe dokumentacionin e lëndës, i cili me datën 30. 01. 2024 ka dorëzuar raportin me rekomandimin që ndaj OE të aplikohet neni 992. par 2 i LPP-së.

Paneli Shqyrtues i OSHP, ka konvokuar seancën dëgjimore për shqyrtimin dhe administrimin e provave të lëndës pa prezencën e palëve sepse nga shkresat e lëndës kishte prova të mjaftueshme që të merret vendimi përfundimtar.

Paneli shqyrtues, bazuar në shkresat e kësaj lënde dhe provat e administruara, ka konstatuar se qëndrojnë pohimet e AK, sikurse janë përshkruar ato si më sipër, që OE “Creative Design” ka bërë paraqitjen e të dhënave të rreme pasi që është vërtetuar se Autoriteti Kontraktues përveç kërkesave tjera kualifikuese në dosje të tenderit ka kërkuar nga OE-të të sjellin ateset nga një laborator i akredituar për të vërtetuar se i përmbushin specifikat teknike për produktet që ofrohen nga ana e OE-ve lidhur me furnizimet e kërkuara.

Autoriteti Kontraktues për këtë furnizim tri herë radhazi e ka publikuar aktivitetin e prokurimit dhe gjate vlerësimin të ofertave ka hasur në dyshime se OE “Creative Design” ka ndërhyrë në ateste (certifikata të kualitetit) pasi që behet fjale për të njëjtën certifikatë me të njëjtin nr. reference por e cila ka ndryshme në përmbajtjen e saj, dhe lidhur me këto dyshime Policia e Kosovës ju ka drejtuar laboratorit nga i cili është lëshuar certifikata e kualitetit lidhur me atestet e prezantuara nga OE dhe sipas konfirmimeve rezulton se vetëm certifikata me nr. refer. 25/23 e datës 10.07.2023 e lëshuar për aktivitetin e prokurimit me nr. 214-23-5853-121 është e lëshuar nga ana e tij ndërsa të gjitha certifikatat tjera janë të paqarta dhe nuk korrespondon me datën dhe numrin e lëshuar.

Andaj mbi bazën e të lartcekurave sipas analizave rezulton se OE “Creative design” në të trija procedurat e zhvilluara për këtë aktivitet të prokurimit ofron certifikatë nga laboratori "Euromak Kontrol nga Shkupi të cilat certifikata përmbajnë të njëjtin numër por dallojnë sipas dëshmime të ofruara nga AK- Policia e Kosovës dhe konfirmimeve të laboratorit nga i cili është lëshuar certifikata e kualiteti (atestit) shihet se OE ka ndërhyrë në dokument ku e njëjta certifikatë përmbanë numër të njëjtë (25/23) dhe të dhëna të ndryshme duke iu referuar tri aktivitetëve të prokurimit që nënkupton se

Paneli shqyrtues pa pasur nevojë për analiza tjera shtesë, nga dokumentacioni i lëndës, konstatimit i dhënë nga eksperti shqyrtues, vlerëson se OE ka ndërhyrë në përmbajtjen e dokumentit dhe kjo nënkupton që kemi të bëjmë me falsifikim/mashtrim, dhe në kuptim të nenit 99.2 të LPP-së Andaj paneli shqyrtues OE “Creative Design” e diskualifikon nga aktivitetet e prokurimit publik për një periudhë një (1) vjeçare pasi certifikata e njëjtë kualitetit është përdorur në tri aktivitet të prokurimit duke ndryshuar datën dhe numrin e prokurimit dhe një gjë të tilla as në përgjigjen OE e tij dërguar për policinë Kosovës nuk e mohon as nuk e pohon se ka ndërhyrje në certifikatën e kualitetit.

Paneli Shqyrtues, bazuar në kompetencat e parapara me nenin 105, të LPP, i komunikoi AK po ashtu Urdhrin për konfiskim të sigurimit të ofertës ndaj OE “Creative Design” sipas pikës 2, të dispozitivit të këtij vendimi, nëse AK nuk e ka aplikuar masën e sigurimit të cituar si më sipër, në zbatim të nenit 57, paragrafi 1.1, të LPP, sipas të cilit “Autoriteti kontraktues vendos, duke u bazuar në fakte të verifikuara se tenderuesi në fjalë i ka dhënë autoritetit kontraktues informacione përmbajtësish të gabueshme ose mashtruese”. Paneli vendosi si në dispozitiv duke e diskualifikuar për 6 muaj me arsyetimin se i njëjti nuk ka falsifikuar përmbajtjen e dokumentit por ka bere vetem ndryshim te numrin të prokurimit te aktivitetit, kurse si arsyetim ka dhëne se ky ndryshim është bere nga ta ne mungese te mjeteve financiare për ti ripërsëritur atestet për faktin se nuk dihet nga ta nëse potencialisht do të ishte fitues në rastin konkret, atestet janë reale se ky aktivitet është anuluar dy here nga AK .

Duke ju referuar të lartcekurave si dhe duke u bazuar në dispozitivin e nenit 99.2 të LPP, Paneli shqyrtues, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetari i Panelit
Vedat Poterqori



Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, kurse pala e pakënaqur ka të drejtë që ti drejtohet me kërkesëpadi Gjykatës Kompetente për anulim vendimi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – KK Prishtinë

1x1 OE “Creative Design”

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së